



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KËSHILLI BASHKIAK**

Shijak më 17.02.2026

RAPORT

Për Punën e Këshillit të Bashkisë për 12 - mujin e vitit 2025

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak Shijak mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga kuadri ligjor në fuqi, në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vet këshilli si më poshtë:

1. Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Ligji nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore”
3. Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetë-Qeverisjen Vendore”
5. Ligji nr. 44, datë 30.4.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative”
6. Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për Funkionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”
7. Ligji nr.107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”
8. Ligji nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”

Adresa:Lagja”Erzen”Shijak,Tel:+35557122512,ëbsite:ëëë.shijak.gov.al,email:info@shijak.gov

9. Ligji nr. 146, datë 30.10.2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"
10. Ligji nr. 68, datë 27.04. 2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
11. Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
12. Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri"
13. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"
14. Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat"
15. Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave", i ndryshuar
16. Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"
17. Ligji nr. 138, datë 17.12. 2015 "Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike". 19. Ligji nr. 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile", i ndryshuar
18. Rregullore e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Shijak , me Vendim nr.11, datë 22.02.2020
19. Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të Këshilltarit Bashkiak", me Vendim nr.21, datë 03.04.2020
20. Rregullore për marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median, me Vendim nr.22, datë 03.04.2020
21. Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare, me Vendim nr.53, datë 08.06.2020.
22. Etj.

Këshilli i Bashkisë Shijak, gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2025, është fokusuar në trajtimin e çështjeve dhe shqetësimeve që kanë kërkuar vëmendje të veçantë, me synimin për të garantuar ofrimin e një shërbimi sa më cilësor dhe të përgjegjshëm ndaj komunitetit. Në ushtrim të kompetencave të tij dhe në mbështetje të shtresave në nevojë, Këshilli ka miratuar çdo muaj vendime për dhënie e ndihmës financiare për familje dhe individë që përballen me vështirësi ekonomike apo situata të veçanta sociale. Këto mbështetje financiare janë akorduar jo vetëm nga fondi i kushtëzuar për ndihmën ekonomike, por edhe nga të ardhurat e vetë Bashkisë Shijak, duke reflektuar angazhimin institucional për të qenë pranë qytetarëve dhe për të adresuar nevojat e tyre. Në vijim paraqiten vendimet e marra gjatë kësaj periudhe:

Nr.	Muaji	Ndihmë ekonomike për familje nga të ardhurat e Bashkisë
1.	Janar	-
2.	Shkurt	66
3.	Mars	67
4.	Prill	67
5.	Maj	66
6.	Qershor	67
7.	Korrik	69
8.	Gusht	69

Adresa:Lagja"Erzen"Shijak,Tel:+35557122512,ëbsite:ëëë.shijak.gov.al,email:info@shijak.gov

9.	Shtator	69
10.	Tetor	69
11.	Nëntor	71
12.	Dhjetor	70

Këshilli i Bashkisë Shijak, gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, ka zhvilluar veprimtarinë e tij vendimmarrëse në përputhje me kompetencat ligjore dhe përgjegjësitë institucionale, duke marrë një sërë vendimesh të rëndësishme që lidhen me mirëfunksionimin e administratës vendore, përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të bashkisë. Në vijim paraqiten vendimet kryesore të miratuara nga Këshilli i Bashkisë Shijak gjatë kësaj periudhe:

1. Mbi përcaktimin e kriterëve specifike dhe dokumentacionit për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve me probleme social-ekonomike.
2. Mbi miratimin e kodeve të granteve të rindërtimit në zbatim të VKM-së nr. 836, 837, datë 26.12.2024.
3. Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shijak për vitet 2026-2028.
4. Mbi dhënien e autorizimit Kryetarit të Bashkisë Shijak, Z. Elton Arbana, për firmosjen e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shijak dhe Projektit Bashki të Forta.
5. Mbi hartimin e tavaneve përgatitore të buxhetit afatmesëm 2026-2028.
6. Për dhënien e ndihmës ekonomike në lidhje me fondin e veçantë.
7. Për shtesë buxheti për vitin 2025 për pjesën e të ardhurave të trashëguara nga viti 2024.
8. Për miratimin e sistemit të pikëzimit dhe dokumentacionit që duhet të plotësojnë individët/familjet që të përfitojnë nga programi i subvencionimit të interesave të kredive.
9. Mbi hartimin e projektit të parë të dokumentit për Buxhetin Afatmesëm për vitet 2026-2028 të Bashkisë Shijak.
10. Mbi Monitorimin e Buxhetit të Bashkisë Shijak për periudhën Janar -Dhjetor 2024.
11. Rdorimin e fondit të Emergjencave Civile të Bashkisë Shijak për vitin 2025.
12. Për azhornimin dhe saktësimin e listës së personave të pastrehë të cilët janë prekur nga zbatimi i projektit “Rindërtimi i Shkollës Muharrem Dollaku”, si dhe miratimi i “Bonus Strehimi”.
13. Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje, kullota e pemëtari, viti 2025.
14. Për miratimin e Planit të përballimit për emergjencat civile dhe krizat.
15. Për akomodimin e përfituesve të cilët nuk kanë vend për rindërtimin në truallin ekzistues nga programi i zhvillimit të zonave të reja në ndërtesat me njësi banimi (pallat).
16. Për emërtimin e segmenteve rrugore.
17. Për shpronësimin e tokës me sipërfaqe 14,800 m² (pasurive nr. 191/21 me sipërfaqe 7350 m² dhe me sip. 7450 m² në ZK 1727) për zgjerimin e varrezave publike në

Adresa: Lagja "Erzen" Shijak, Tel: +35557122512, ëbsite: ëëë.shijak.gov.al, email: info@shijak.gov

Bashkinë Shijak.

18. Për miratimin e listës emërore të aplikantëve të cilët kanë plotësuar dokumentacionin që të përfitojnë nga programi i subvencionimit të interesave të kredive.
19. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 112, datë 07.12.2020 “Mbi miratimin e listës progresive të familjarëve për përfitimin sipas programit të granteve të rindërtimit dhe projekteve model”.
20. Mbi miratimin e akt-marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Shijak dhe Utilis, organizatë jofitimprurëse.
21. Për miratimin në parim të marrëveshjes së shërbimit për tërheqjen dhe depozitimin e mbetjeve, të cilat për shkak të klasifikimit të tyre nuk depozitohen në landfillin e Sharrës nga Bashkia Shijak.
22. Për miratimin e Planit të mbarështimit për ekonominë pyjore “Shijak-Mamínas”; afati për zbatimin e këtij plani është 10 vite.
23. Për miratimin e zonave prioritare të zhvillimit në territorin e Bashkisë Shijak, në zbatim të ligjit 20/2025 “Për Paketën e Maleve”.
24. Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA).
25. Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028 në Bashkinë Shijak.
26. Mbi ndryshimin e buxhetit të Bashkisë Shijak për vitin 2025.
27. Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore të Bashkisë Shijak 2026-2028.
28. Mbi shtimin e numrit të punonjësve në strukturën e Bashkisë Shijak për vitin 2025.
29. Për miratimin e listës emërore dhe masës së dëmit të të dëmtuarve nga zjarret e rena në periudhën korrik-shtator, në fshatin Shetel dhe Kënetë të Nj.A. Gjepalaj dhe fshatin Pjezë të Nj.A. Xhafzotaj.
30. Mbi përdorimin e fondeve në zbatim të Aktit Normativ nr. 10, datë 08.10.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 ‘Për buxhetin e vitit 2025’”.
31. Për miratimin e akt-ekspertizës së thelluar dhe vlerave të rikonstruksionit të banesave individuale me shkallë dëmtueshmërie DS4-retrofit sipas projekteve dhe preventivave përkatëse.
32. Për miratimin e Planit të Strehimit Social Vendor 2026-2031.
33. Mbi mbarimin e mandatit të Z. Bruno Guri.
34. Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Shijak (Republika e Shqipërisë) dhe Bashkisë Karnobat (Republika e Bullgarisë).
35. Për miratimin e sistemit të pikëzimit dhe dokumentacionit që duhet të plotësojnë individët/familjet që të përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët.
36. Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve për vitin 2025 për Bashkinë Shijak.
37. Për Paketën Fiskale 2026.
38. Mbi përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike.
39. Për miratimin e Planit të Punës/Konsultimeve/Buxhetit të Këshillit Bashkiak Shijak për vitin 2026.

Adresa:Lagja"Erzen"Shijak,Tel:+35557122512,ëbsite:ëëë.shijak.gov.al,email:info@shijak.gov

40. Për dhënie mandati Z. Mentor Jamaku.
41. Mbi miratimin e projektit të Buxhetit Afatmesëm për vitet 2026-2028, përfundimtar, dhe Buxhetin e vitit 2026 për Bashkinë Shijak.

(Sqarim: Gjatë periudhës shkurt-dhjetor 2025 janë marrë 11 vendime "Për dhënien e ndihmës ekonomike në lidhje me fondin e vecantë " dhe 4 vendime "Për emërtimin e segmenteve rrugore në Bashkinë Shijak ".

Për periudhën janar – dhjetor 2025, janë marrë 56 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Shijak.

(Bashkëngjitur materialit gjeni dosjen e vendimeve ku është përcaktuar saktë numri i vendimit, data e vendimit, data e shpalljes së vendimit, titulli i vendimit, data e miratimit nga Prefekti dhe nr.i fletëve të vendimit dhe dokumentave shoqëruese të tij të cilat janë të publikuara dhe në faqen e internetit të Këshillit.

Vlen për tu theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Shijak kanë qenë konform ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave. Për vendimet e marra nga ky këshill për 12 mujorin e vitit 2025 institucioni i Prefektit të Qarkut është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre për vendimet e marra me përjashtim të VKB nr.13 pika 1, VKB nr.21, VKB nr.26 , VKB nr.27 , VKB nr.29, VKB nr.40 , VKB nr.41, VKB nr.42 pika 1, VKB nr.47 të cilët Prefekti nuk i ka konfirmuar ligjshmërinë . Nuk janë dërguar për verifikim ligjshmërie vetëm vendimet me karakter individual, sipas kërkesës së Prefekturës së Qarkut Durrës.

Nga Prefektura Durrës është kryer kontroll periodik çdo 3 muaj për periudhat janar–mars, prill–qershor, korrik–shtator dhe tetor–dhjetor, sipas legjislacionit, dhe në raportet e tyre është cilësuar se Këshilli Bashkiak Shijak ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet ligjore dhe rekomandon:

- Rishikimin e rregullore në mënyrë që kjo rregullore të jetë sa më korrekte dhe e qartë për të mundur mbarëvajtjen e punës së Këshillit.
- Paraqitjen për verifikim ligjshmërie të akteve pranë Prefektit të Qarkut, akteve nënligjore me karakter normativ, në zbatim të nenit 8/a të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", si dhe nenit 16 të këtij ligji.

Nga sa thamë më lart, këto vendimmarrje të këshillit flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Shijakut.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka qenë mjaft aktiv, duke mbajtur mbledhje të radhës, mbledhje jashtë radhe dhe mbledhje të jashtëzakonshme, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	DATA E MBLËDHJES	ORA	VENDI I ZHVILLIMIT
-----	------------------	-----	--------------------

Kalendari i zhvillimit të mbledhjeve paraqitet si më poshtë :

Periudha	Nr i mbledhjeve	Mbledhje të radhës	Mbledhje jashtë rradhe	Mbledhje të jashtëzakonshme
6 mujori parë	6	6	0	0
6 mujori dytë	10	6	4	0
Total 12 mujori	16	12	4	0

Muaji	Nr i mbledhjeve	Mbledhje të radhës	Mbledhje jashtë rradhe	Mbledhje të jashtëzakonshme
Janar	1	1 (07.02.2025)	-	-
Shkurt	1	1 (13.02.2025)	-	-
Mars	1	1 (17.03.2024)	-	-
Prtill	1	1 (27.04.2025)	-	-
Maj	1	1 (30.05.2024)	-	-
Qershor	1	1 (01.07.2024)	-	-
Total 6 mujori parë	6	6	0	0
Korrik	2	1 (17.07.2025)	1 (24.07.2025)	-
Gusht	1	1 (26.08.2024)	-	-
Shtator	2	1 (24.09.2025)	1 (08.09.2025)	-
Tetor	1	1 (17.10.2025)	-	-
Netor	2	1 (21.11.2025)	1 (07.11.2025)	-
Dhjetor	2	1(22.12.2025)	1 (09.12.2025)	-
Total 6 mujori dytë	10	6	4	0

1.	07.02.2025	17:00	Salla e mbledhjeve të KB
2.	13.02.2025	17:00	Salla e mbledhjeve të KB
3.	17.03.2025	17:00	Salla e mbledhjeve të KB
4.	27.04.2025	17:00	Salla e mbledhjeve të KB
5.	03.06.2024	17:00	Salla e Mbledhjeve të KB
6.	30.05.2025	17:00	Salla e mbledhjeve të KB
7.	01.07.2025	17:00	Salla e mbledhjeve të KB
8.	17.07.2025	18:00	Online
9.	24.07.2025	18:00	Online
10.	26.08.2024	18:00	Salla e mbledhjeve të KB
11.	24.09.2025	17:00	Salla e mbledhjeve të KB
12.	17.10.2025	17:00	Salla e mbledhjeve të KB
13.	07.12.2025	17:00	Salla e mbledhjeve të KB
14.	21.11.2025	17:00	Salla e mbledhjeve të KB
15.	09.12.2025	17:00	Salla e mbledhjeve të KB
16.	22.12.2025	17:00	Salla e mbledhjeve të KB

Siç shihet dhe nga kalendari i mbledhjeve gjatë muajit Janar-Dhjetor 2025, 2 mbledhje të Këshillit janë zhvilluar online, përveç 14 mbledhjeve, ku Këshilli ka mbajtur senacën plenare në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak .

Komisionet e përhershme të këshillit janë mbledhur për të diskutuar dhe miratuar projekt vendimet e sjella nga administrata e Bashkisë Shijak. Për periudhën 12-mujore janë bërë 20 mbledhje të komisioneve të përhershëm.

Nr.	Muaji	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm
1.	Janar	0
2.	Shkurt	3
3.	Mars	1
4.	Prill	0
5.	Maj	2
6.	Qershor	1
	Total 6 mujori I-rë	7
7.	Korrik	0
8.	Gusht	1
9.	Shtator	2
10.	Tetor	1
11.	Nëntor	2
12.	Dhjetor	7
	Total 6 mujori II-të	13
	TOTALI 12 MUJOR	20

Adresa:Lagja"Erzen"Shijak,Tel:+35557122512,ëebsite:ëëë.shijak.gov.al,email:info@shijak.gov

Në çdo rast Komisionet e Përhershme në zbatim të “Rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Shijak” kanë mbajtur raportin përfundimtar ku pasqyrohet vendimmarrja e secilit komision për pikat e rendit të ditës që u caktohen për tu shqyrtuar, sipas tabelës se mëposhtëme:

Nr.	Komisioni	6 mujori parë 2024					
		RAPORTE E PROÇESVERBALE TE KOMISIONEVE sipas pikave të rendit të ditës					
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
1.	Komisioni Mandateve	-	-	-	-	-	-
2.	Komisioni Buxhetit, Financës dhe Taksave- Tarifave	-	2	1	-	1	-
3.	Komisioni i Strehimit, Mbrojtjes Civile Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike,	-	-	-	-	-	-
4.	Komisioni Kulturës, Arsimit, Shëndetësisë , Sporteve, Komuniteteve Fetare	-	-	-	-	-	-
5.	Komisioni i zhvillimit Urban, Përdorimit të Tokës dhe Mjedisit	-	1	-	-	-	-
6.	Komisioni Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale	-	-	-	-	-	-
7.	Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor	-	-	-	-	1	1
8.	Komisioni i Auditit dhe kontrollit Financiar	-	-	-	-	-	-
	Totali – 7	0	3	1	0	2	1

Nr.	Komisioni	6 mujori dytë 2024					
		RAPORTE E PROÇESVERBALE TE KOMISIONEVE sipas pikave të rendit të ditës					
		Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor

Adresa: Lagja "Erzen" Shijak, Tel: +35557122512, eëbsite: eëë.shijak.gov.al, email: info@shijak.gov

zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar parimin e transparencës dhe duke mundësuar informimin e qytetarëve mbi çështjet që trajtohen dhe vendimet që merren.

Është përditësuar faqa online e Këshillit Bashkiak me informacione për publikun nëpërmjet kartelave të mëposhtëme :

Rreth Keshillit Bashkiak

Kryetari i Keshillit

Sekretari i Keshillit

Struktura e Keshillit Bashkiak

Anetaret e Keshillit Bashkiak

Komisionet e Keshillit

Konferenca e Kryetarëve

Legjislacioni

Rregulloret

Kalendari Mbledhjeve Të Këshillit dhe Plani I Aktiviteteve

Njoftime (KB)

Proçesverbalet e mbledhjeve të KB

Vendime te Keshillit Bashkiak

Konsultimet Publike

Regjistri i projekt akteve per konsultim publik te keshillit bashkiak

Raporte të Këshillit

Model formatesh për t'u shkarkuar nga komuniteti

Regjistri elektronik i kërkesave, ankesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare

Regjistri publik per transparencen e mbledhjeve te Keshillit

Në zbatim të Programit të Transparencës, për vitin 2025 është hapur kartela “Kalendari i Mbledhjeve të Këshillit dhe Plani i Aktiviteteve”, në të cilën janë pasqyruar në mënyrë të rregullt datat e zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, si dhe aktivitetet kryesore të planifikuara gjatë vitit. Publikimi i këtij informacioni ka për qëllim informimin në kohë të qytetarëve dhe rritjen e transparencës mbi veprimtarinë e Këshillit Bashkiak, duke mundësuar akses më të lehtë të publikut në proceset vendimmarrëse dhe në aktivitetet institucionale të tij.

Sekretariati i Këshillit ka zbatuar me korrektësi kërkesat e ligjit për njoftimet publike (*si në faqen zyrtare të Bashkisë, me email drejtuar Drejtorëve të bashkisë, Kryetarëve të Njësisve Administrative, në këndin e informacionit në zyrën e mardhënieve me publikun në Bashkinë Shijak në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar dhe*

Adresa:Lagja”Erzen”Shijak,Tel:+35557122512,ëbsite:ëëë.shijak.gov.al,email:info@shijak.gov

Rregulloren e Funkionimit të Këshillit të Bashkisë Shijak.

Në zbatim të rregullores së miratuar me Vendim nr.53, datë 08.06.2020 është vënë në funksionim regjistri elektronik dhe fizik i ankesave/kërkesave dhe i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbërritura në drejtim të Këshillit. Në Sekretariat si me shkresa dhe me email, janë dorëzuar 0 ankesa dhe 5 kërkesa, të cilave sekretariati në bashkëpunim me Kryetarin e Këshillit apo dhe ndonjë Komision i Përhershëm, i është përgjigjur, brënda afateve ligjore. Forma e komunikimit ka qënë me email ose me postë.

Këshilli duke ju përshtatur dhe risive të teknologjisë për përçimin sa më shpejt të njoftimeve apo komunikimit direkt me qytetarët ka aktiv faqen e tij në rrjetin social facebook në të cilën bën njoftimet për mbledhjet e tij si dhe merrvërejtje, ankesa, kërkesa e sygjerime nga qytetarët të ndryshëm. Të gjitha mbledhjet plenare të këshillit janë transmetuar direkt dhe nëpërmjet këtij rrjeti, ku komuniteti ka ndjekur direkt mbledhjen dhe ka dhënë mendimet për çështjet që janë shqyrtuar. Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës në fund të çdo mbledhje është lënë një hapësirë për pyetje nga komuniteti (kërkesa apo ankesa), që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë Këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë, të cilat kanë marrë përgjigje të drejtë për drejtë nga administrata e bashkisë.

Këshilli Bashkiak, në buxhetin e tij të miratuar për vitin 2025, ka patur të parashikuar fondin prej 700,000 lekë, miratuar me VKB nr. 43, datë 10.12.2024. Ky fond është planifikuar për të mbështetur veprimtarinë e Këshillit Bashkiak, përfshirë zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese. Nga ky fond, gjatë vitit 2025 janë shpenzuar 100,000 lekë, të cilat janë përdorur për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese dhe shkëmbimin e përvojave profesionale, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e praktikave të punës së Këshillit Bashkiak.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, gjatë vitit 2025 janë zhvilluar disa trajnime dhe aktivitete për ndarjen e përvojave, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të Këshillit Bashkiak, konkretisht:

- Më 17.01.2025, në Tiranë, u zhvillua aktiviteti “Aktivitete në përmbajtje/implementim të eksperiencave të marra nga Study Tour Lausanne/Sëitserland”, në të cilin mori pjesë Sekretarja e Këshillit.
- Në datat 02–03.07.2025, në Golem, u zhvillua trajnimi me temë “Ligjvënja me ndjeshmëri gjinore në nivel vendor në Shqipëri”, ku morën pjesë Sekretarja e Këshillit dhe këshilltaret femra të Këshillit Bashkiak.
- Në datat 17–18.11.2025, në Pogradec, u zhvillua aktiviteti “From Sëitserland to practice – ëhat ëe have achieved one year after the Lausanne study visit”, në të cilin mori pjesë Sekretarja e Këshillit.

Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe në shkëmbimin e praktikave të mira në funksion të përmirësimit të punës dhe rolit të Këshillit Bashkiak në

ushtrimin e përgjegjësive të tij.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2025, Këshilli Bashkiak, në bashkëpunim me Bashkinë Shijak, ka zhvilluar një sërë dëgjeshash publike me qytetarët dhe grupet e interesit. Këto dëgjesa kanë pasur si qëllim informimin e komunitetit, marrjen e mendimeve dhe sugjerimeve nga publiku, si dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse për çështje të rëndësishme të zhvillimit vendor.

Në total janë zhvilluar 6 dëgjesa publike, konkretisht:

- Më datë 23.07.2025 u zhvillua dëgjesa publike për "Planin e Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore Shijak–Maminas 2025–2034".
- Më datë 22.08.2025 u zhvillua dëgjesa publike për "Planin e Arsimit Parauniversitar 2026–2028 të Bashkisë Shijak".
- Më datë 01.09.2025 u zhvillua dëgjesa publike për "Planin Vendor të Barazisë Gjinore 2026–2028 për Bashkinë Shijak".
- Më datë 29.10.2025, në Njësinë Administrative Xhafzotaj, u zhvillua dëgjesë publike për "Planin 5-vjeçar të Strehimit Social të Bashkisë Shijak", si dhe për dokumentet financiare "Paketa Fiskale 2026" dhe "Buxheti Afatmesëm 2026–2028".
- Më datë 30.10.2025, në Njësinë Administrative Gjepalaj, u zhvillua dëgjesë publike për "Paketën Fiskale 2026" dhe "Buxhetin Afatmesëm 2026–2028".
- Më datë 31.10.2025, gjithashtu në Njësinë Administrative Gjepalaj, u zhvillua dëgjesë publike për "Paketën Fiskale 2026" dhe "Buxhetin Afatmesëm 2026–2028".

Këto dëgjesa publike kanë shërbyer si një mekanizëm i rëndësishëm për rritjen e transparencës, përfshirjen e komunitetit në proceset vendimmarrëse dhe forcimin e komunikimit ndërmjet institucioneve vendore dhe qytetarëve të Bashkisë Shijak.

Vlen të përmendet fakti se pjesa më e madhe e propozimeve nga komuniteti u reflektuan në buxhetin e Bashkisë Shijak për vitin 2026.

Këshilli nëpërmjet faqes së tij online ka hapur një rubrikë të konsultimeve me publikun si një nga mënyrat e pjesëmarrjes së komunitetit për të përcjell shqetësimet e sugjerimet e tij. Dhe në këtë faqe publikohen të gjitha projektvendimet, që sipas ligjit para se të shqyrtohen kërkojnë seanca dëgjimore. Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj me qëllim pjesëmarrja aktive në vendimmarrjen e komunitetit. Gjithashtu, del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative të cilat do të diskutohet dhe vendoset në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Vlen të përmendet se gjatë vitit 2025, Këshilli Bashkiak ka miratuar disa plane strategjike

Adresa:Lagja"Erzen"Shijak,Tel:+35557122512,ëbsite:ëëë.shijak.gov.al,email:info@shijak.gov

të rëndësishme, të cilat synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe përmirësimin e shërbimeve për komunitetin. Konkretisht, janë miratuar:

- Plani i Mbarështrimit të Ekonomisë Pyjore Shijak–Maminas 2025–2034”.
- Plani i Arsimit Parauniversitar 2026–2028” i Bashkisë Shijak.
- Plani i Barazisë Gjinore 2026–2028” për Bashkinë Shijak.
- Plani 5-vjeçar i Strehimit Social” i Bashkisë Shijak.

Pas miratimit të këtyre planeve, u aplikua në kuadër të Grantit të Performancës, ku Bashkia Shijak përfitoi fonde të veçanta për tre sektorë kryesorë: pyjet, arsimin dhe shërbimet sociale. Këto fonde do të përdoren për të financuar projekte konkrete sociale dhe arsimore gjatë vitit 2025 dhe në vijim, duke siguruar zbatimin e planeve strategjike dhe përmirësimin e mirëqenies së komunitetit.

Punë të mbarë dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush!

Falenderimet gjithashtu shkojnë për:

- Falenderojmë për punën e palodhur administratën e Bashkisë Shijak dhe mbështetjen që i kanë dhënë Sekretariatit të Këshillit dhe në vecanti Kryetarin e Bashkisë Z. Elton Arbana.
- Falenderojmë për asistencën e pamunguar Projektin “Bashki të Forta” .

SEKRETARI I KËSHILLIT

Kezeta Doda

